



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3334 / Prot.
3

Tiranë, më 23.12.2021

VENDIM

Nr. 72, datë 23.12.2021

PËR

**“TARIFAT E KONKURIMIT, TË APLIKIMIT DHE TË SHKOLLIMIT NË
PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË TË SPECIALIZIMEVE
AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 100, datë 16.12.2021 “Për miratimin e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2021-2022, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë, të pandryshuar, tarifën e konkurrimit në programet e studimeve të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në masën 5.000 (pesë mijë) lekë.
2. Të miratojë, të pandryshuar, tarifën e aplikimit për transferim të studimeve në programet e studimeve të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në masën 5.000 (pesë mijë) lekë .
3. Të miratojë, të pandryshuar, tarifën vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në masën 115.000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
4. Studentët që shpallen fitues, paguajnë/arkëtojnë menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa këstet e tjera paguhen sipas afateve dhe masës që përcaktohet nga fakultetet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e tij.

6. Ngarkohet Sektori i Koordinimit Institucional, për publikimin e Vendimit në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETAR

ZAMIRA GJINI



ANËTARË

MONIKA FIDA



ANIS THODHORJANI



VERA OSTRENI



ALTINA XHAFERI



ALBANA GJINOPULLI



ENDRIT YZEIRAJ

